



Prishtinë, 27.02.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3083_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2842_01_26** i datës 21.01.2026;
- Ankesa e konsumatorit e dt. 20.02.2026.

në seancën e mbajtur më datë 27.02.2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **F. R.**, nga fsh. Dobratin, Komuna e Podujevës, si e pabazuar.
- II. **MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2842_01_26 i datës 21.01.2026.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me datë 21.01.2026 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2842_01_26 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit F. R., lidhur me kërkesën për dislokimin e TS si dhe për kompensimin financiar nga ana e OSSH-së.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori përmes Agjencisë për Ndihmë Jurdike Falas, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- E kundërshtoj konstatimin që nuk kam siguruar lokacion për zhvendosjen e TS, sepse një kërkesë e tillë nuk më është paraqitur nga OSSH;
- Vendosja e TS në pronën time, e cënon të drejtën time pronësore dhe pengon shfrytëzimin normal të pronës.
- Kërkoj nga Bordi i ZRRE-së që të anulohet Vendimi i kontestuar dhe të obligohet OSSH-ja që të bashkëpunojë me konsumatorin për gjetjen e zgjidhjes teknike të arsyeshme dhe proporcionale dhe kompensim më faturë të energjisë elektrike.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Transaksionet e konsumatorit, Rrjedha e Energjisë Elektrike, Listat e Leximi, informatën e lëshuar nga KEDS date 31.08.2021 si dhe kërkesën e konsumatorit për dislokim apo kompensim prone. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Në vështrim kronologjik të këtij rasti, Bordi ka gjetur se, pasi që konsumatori ka parashtruar kërkesë për dislokim/zhvendosje të trafos, me date 31.08.2021 Divizioni i Shpërndarjes në KEDS, i ka lëshuar informatën me nr. 8478 në të cilën është theksuar se: Pas vizitës në teren me date 27.08.2021 konsumatori ka kërkuar zhvendosjen e trafos, mirëpo nuk ka siguruar lokacion për zhvendosje. Prandaj zgjidhje teknike nuk mund të punohet dhe lënda mbyllet. Me date 13.05.2025 konsumatori ka përsëritur ankesën dhe se me date 23.07.2025 KESCO ka lëshuar vendimin me të cilën refuzohet ankesa si dhe është evidentuar që: “Ju keni dorëzuar një kërkesë për Zgjidhje teknike/dislokim dhe për këtë ju keni pranuar një përgjigje /informatë nga OSSH (KEDS) nr. 8478 datë 01.09.2021 sipas të cilës ju nuk i keni plotësuar kushtet që të ju ofrohet një zgjidhje teknike (nuk keni siguruar lokacionin për vendosjen e trafos)”.

Bordi pasi që e ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes ankesën e konsumatorit, ka gjetur se, ankesa është e pabazuar, sepse, duke u bazuar në nenin 17 të Metodologjisë së Taksave të Kyçjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, Zhvendosja–Dislokimi i aseteve të OSSH-së, e ku thuhet se: 1. *“Aplikuesit/Konsumatorët kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesa për zhvendosjen e aseteve të OSSH, në rastet kur asetet e OSSH mund të paraqesin pengesa të ndryshme, ose edhe për shkaqe të rrezikut.* 2. *OSSH është e obliguar të kthejë përgjigje me shkrim aplikuesve/konsumatorëve lidhur me kërkesat për zhvendosjen e aseteve të OSSH brenda afatit prej 30 ditëve kalendarikë, për lejin ose mos lejin e zhvendosjes së aseteve të OSSH.* 3. *Në rast se OSSH nuk lejon që të bëhet zhvendosja e aseteve të OSSH, atëherë OSSH është e obliguar të japë përgjigje me arsyet e refuzimit të zhvendosjes.* 4. *Në rastet kur OSSH lejon që të bëhet zhvendosja e aseteve të OSSH, atëherë OSSH është e obliguar të lëshojë aplikuesit zgjidhjen teknike për zhvendosje të aseteve të OSSH, dhe shpenzimet e zhvendosjes të aseteve të OSSH duhet të bëhen nga aplikuesit/konsumatorët,* 5. *Aplikuesi/Konsumatori mund të zgjedhë që punimet e zhvendosjes së aseteve të OSSH të kryhen nga OSSH sipas taksave të OSSH apo nga një kompani e licencuar”.* Nga dokumentacioni i ofruar nga palët vërtetohet se ekipet e KEDS kanë bërë inspektimet e kërkuara si dhe KEDS me datë 01.09.2021 përmes informatës nr. 8478 ka informuar aplikuesin se për shkak të mos ofrimit të lokacionit për zhvendosjen e Trafos nuk mund t’i ofrohet Zgjidhje Teknike dhe se për këtë arsye edhe mbyllet kërkesa e parashtruar. Po ashtu vërtetohet se KEDS i ka kthyer Përgjigje/Vendim konsumatorit në ankesën e tij si dhe është informuar mbi arsyen e mos lëshimit të Zgjidhjes Teknike për dislokimin e trafos, përkatësisht në përgjigje është potencuar informata nr. 8478 date 01.09.2021 si dhe është njoftuar mbi procedurat si dhe kostot e përcaktuar të zhvendosjes së aseteve të OSSH-së .

Po ashtu, duke u bazuar edhe në Ligjin Nr. 05/L-081 për Energjinë e që ka të bëjë me të drejtat pronësore të ndërmarrjeve të energjisë, përkatësisht nenin 26 - Stabilimentet e reja dhe ekzistuese energjetike thuhet se: Stabilimentet e reja dhe ato ekzistuese për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, termike ose të gazit natyror, do të jenë në pronat mbi të cilat ndërmarrja përkatëse e energjisë i gëzon të drejtat përkatëse të pronësisë, të shfrytëzimit ose të



qasjes. Linjat dhe tubacionet për transmetim dhe shpërndarje të energjisë mund të kalojnë përmes, mbi, në ose nën çdo pronë vetëm nëse ndërmarrja përkatëse e energjisë ka një servitut ose të drejtë të shfrytëzimit të pronës përkatëse, ose servituti apo e drejta e shfrytëzimit i jepet ose i merret nga ndërmarrja përkatëse energjetike në përputhje me këtë ligj dhe me aktet nënligjore të aprovuara nga Ministria në bazë të këtij ligji, kurse neni 27 - Prona e cila aktualisht është në shfrytëzim ose posedim të ndërmarrjeve të energjisë në paragrafin 1 thuhet se: Çdo ndërmarrje e energjisë e cila ka në pronësi, shfrytëzim ose ka të drejtën e shfrytëzimit, operon ose ka në posedim stabilimente energjetike të vendosura në një pronë për të cilën ndërmarrja e energjisë nuk ka siguruar ose nuk i është dhënë formalisht një servitut, të drejtën e shfrytëzimit ose të drejtën pronësore dhe këto stabilimente energjetike janë në posedim ose shfrytëzim të ndërmarrjes së energjisë, atëherë kjo ndërmarrje do të ketë të gjitha servitutet, të drejtat e shfrytëzimit dhe të drejtat tjera pronësore në ose ndaj pronës përkatëse. Këto servitute, të drejta të shfrytëzimit ose të drejta pronësore u nënshtrohen kushteve të përcaktuara në këtë nen.

Përfundimisht, duke qenë se, sipas pikës 1.1.3 të Kodit të Shpërndarjes së OSSh-së, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSh) është përgjegjës për zhvillimin, operimin dhe mirëmbajtjen e sigurt, të qëndrueshme dhe eficiente të Sistemit të Shpërndarjes, Bordi thekson se, konsumatori është i obliguar që të aplikoj për Zgjidhje Teknike, sipas udhëzimeve të dhëna në informatën nr. 8478 të datës 01.09.2021, pra të përcaktohet lokacioni dhe pastaj të bëhet kërkesa për dislokim.

Bordi i pati në konsideratë edhe disa prova të tjera materiale si në shkresat e lëndës, por që të njëjtat nuk kanë pasur ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë rast.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Bordi i ZRrE-së pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët e ne veçanti Ligjin Nr. 05/L-081 për Energjinë, Metodologjinë e Taksave të Kycjes së OSSh-së, Kodit të Shpërndarjes si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit **F.R.**, (përmes Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas)
- Arkivit të ZRrE-së